



Pranimi / Dorezimi Prilipi / Predaja Receipt / Delivery	20.02.2023	3	viti god year
Organ / Shënjë Org. / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Protog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSACK	1936/2023		112



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.01/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtare si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës A.nr.01/2023 të datës 04.01.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.01/2023 të datës 04.01.2023 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja Udhëheqëse e Sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Drejtoria e Bujqësisë, Pëllltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Gjakovës, më datë 04.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 02/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.01/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga koeficienti aktual gjashtë shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin e pagës në tetë pikë pesë (8.5) dhe pagesën e diferencës për fitimin e humbur (kompensim material.

Kolegji i Këshillit duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesit kanë për objekt çështjen e harmonizimit të koeficientit aktual të pagës, thekson faktin së më datë 05.02.2023 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ku si rrjedhojë me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarëve në sektorin publikë, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.

Për me tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.

Andaj, duke marr parasysh faktin se pas parashtrimit të ankeses nga pala ankuese kanë ndryshuar rrethanat ligjore dhe faktike mbi të cilat janë ngritur pretendimet ankimore, Kolegji i Këshillit konstaton se objekti për të cilën ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, ngase edhe nëse do të kishte vendimarrje pozitive, për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e bazës së re ligjore, koeficienti i ndryshuar i pages nuk mund të aplikohet në sistemin e ri të pagave, dhe rrjedhimisht vlerëson së lidhur me këtë çështje ankimore janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë.*


Përfundimi i këtij procedimi administrativ, palës ankuese nuk ia mohon të drejtën e parashtrimit të ankesës lidhur me koeficientin e pagës sipas sistemit të ri të pagave që rrjedh nga dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë.

Kështu që duke u bazuar në dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrativ, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda. A.nr.01/2023

Rushit KAJTAZI



Procesmbajtës

Eshref SHABANI



Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

